



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:069868
Datë: 02.09.2024
Numri i dokumentit: 06112940

C-IV-14-7059

Ankuesi

M I K, fshati C, Malishevë.

Kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (NSH "NB,, Mirusha- Malishevë" në likuidim), Rr. "Dritan Hoxha" nr. 55, Lakërishte, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), në përbërje nga gjyqtarja Ganimete Puka, kryesuese, gjyqtareve Agron Hoxhaj dhe Bajram Miftari, në seancën vendimmarrëse me 02.shtator. 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e ankuesit konsiderohet e tërhequr.**
- 2. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 17.nëntor.2014 pranë DHPGJS, ankuesi parashtroj ankesë kundër vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL) PRZ008-0080 datë 27. Tetor. 2014, (në tekstin e mëtutjeshëm: Vendimi), me të cilin i është refuzuar kërkesa për njohjen e të drejtës së pronësisë.

Me 16. Qershor. 2024, gjykata lëshoj një vërejtje për ankuesin mbi pagesën e taksës gjyqësore. Me të njëjtën vërejtje ankuesi u informuar se nëse taksat nuk paguhen brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Urdhrin e gjykatës e ka pranuar i autorizuari i tij, me 21.06.2024, dhe deri me ditën e nxjerrjes së këtij aktvendimi nuk është paguar taksë gjyqësore për ankesë.

Arsyetimi ligjor

Ankesa konsiderohet e tërhequr.

Neni 76.3 i Ligjit Nr.06-L-086 për DHPGJS (Ligji nr. 06/L-086) parasheh: *Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore.*

Ankuesi komfor dispozitës së nenit 253.4 të LPK-së ka për detyrë që ankesës t'ia bashkëngjis vërtetimin mbi taksën gjyqësore të paguar. Ne vazhdim dispozita 253.5 parasheh: *Në qoftë se paditësi/ja nuk e paguan taksën gjyqësore të përcaktuar për padinë as pas vërejtjes së dërguar nga gjykata, edhe pse nuk ekzistojnë konditat për lirim nga detyrimi i pagimit të taksës gjyqësore, do të konsiderohet se padia është tërhequr.*

Me 18.qershor. 2024, gjykata përmes vërejtjes kërkoj nga ankuesi, që të bëj pagesën e taksës gjyqësore, duke e njoftuar se ankesa e tij do të konsiderohet e tërhequr nëse ai nuk e paguan taksën gjyqësore. Ankuesi ka për obligim ti paguaj taksat gjyqësore. Taksat gjyqësore aplikohen sipas nenit 63 të Ligjit të DHPGJS-së në lidhje me udhëzimin e KGJK-së Nr. 01/2017, lidhur me taksat gjyqësore.

Urdhri ju është dorëzuar të autorizuarit të ankuesit, me 21.qershor. 2024, dhe i njëjti nuk ju është përgjigjur urdhrin të gjykatës.

Gjykata nga gjitha arsyet e lartcekura nuk ndërmori veprime të mëtutjeshme procedurale si dhe nuk hyri në shqyrtim të çështjes, andaj u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet Gjyqësore

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

Këshillë juridike Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrahet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka, Gjyqtare kryesuese

Agron Hoxhaj , gjyqtar

Bajram Miftari, Gjyqtar
